



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 70

Ora: 23:00

U R D H Ë R

PËR

**PËR DËRGIMIN E LISTAVE EMËRORE TË ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË  
VOTIMIT NE KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE NGA KOMISIONET E ZONAVE TË  
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR**

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “b” e “dh”, dhe pikës 2, të nenit 19, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr.11, datë 25.3.2021, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Kryetari dhe sekretari i KZAZ-së, jo më vonë se ora 23:45 e datës 13.5.2023 duhet të sjellin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve informacion mbi anëtarët e KQV-ve të emëruar prej tyre si dhe numrin e telefonit të gjithsecilit prej tyre.
2. Mosdërgimi i informacionit sipas pikës 1, ngarkon me përgjegjësi ligjore kryetarët dhe sekretarët e KZAZ-ve.
3. Ngarkohen administrata e KQZ-së dhe KZAZ-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet të faqen zyrtare elektronike të KQZ-së.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**